

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Mësimdhënia dhe të nxënit e biologjisë 1
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E hënë 17:00-19:15 Laboratori i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. Dr. Zeqir Veselaj
Detajet kontaktuese:	038 229021 E mail: zeqir.veselaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Fokusi i këtij kursi është që studentët-mësidhënës të pajisen me njohuri shkencore dhe shkathtësi rreth përdorimit të strategjive, metodave dhe teknikave themelore të mësimdhënies për të arritur rezultatet e të nxënit të planifikuara në lëndët biologjike në nivelin e arsimit të mesëm të ultë dhe të lartë.</p> <p>Kursi i ndihmon studentëve-mësimdhënës të ardhshëm që të marrin njohuritë e nevojshme mbi kompetencat (njohuritë dhe shkathtësitë) për mësimdhënien e biologjisë në nivelet e ndryshme kurrikulare të sistemit kombëtar arsimor.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Trajtimi i parimeve teorike dhe modeleve praktike që u japin mundësinë studentëve-mësidhënës të shpalosin në mësimdhënie kreativitetin e tyre për të realizuar qëllimin përfundimtar në mësimdhënie me nxënësin në qendër.</p> <p>Zbatimi i teknikave, metodave dhe strategjive bashkëkohore që trajtohen do të reflektojnë dhe avancojnë praktikën e mësimdhënies në biologji.</p> <p>Studentët do të zotërojnë në mënyrë analitike njohuritë bazë të metodave apo strategjive të mësimdhënies dhe do të japin vlerësim mbi këto metoda.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të këtij kursi, studenti do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përvetsoj konceptet teorike dhe zbatoj në praktikë parimet bazë të mësimdhënies së biologjisë me fokus mësimdhënien me nxënësin në qendër sipas kërkesave të Kurrikulës së Kosovës; - zhvilloj kompetencat për mësimdhënie dhe të nxënit në lëndën e biologjisë përgjatë sistemit kombëtar arsimor në nivelet she shkallët e arsimit të mesëm; - aplikoj metodat më të mira dhe efektive të mësimdhënies dhe të nxënit, përfshirë shembujt e kombinimit të metodave verbale, praktike dhe të dokumentimit për arritjen e rezultateve të të nxënit në biologji; - demonstroj shkathtësi praktike për të përdor dhe aplikuar teknika të ndryshme dhe kreative në mësimdhënien dhe të nxënit e biologjisë në klasë, laborator dhe natyrë;

	- analizoj dhe reflektoj mbi detyrat, përgjegjësitë dhe qëndrimet e mësimeve të biologjisë për motivimin e nxënësve, menaxhimin e klasës gjatë punës me fokus nxënësin në qendër dhe të nxënësve gjatë gjithë jetës.
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësve të studentit)	
Aktiviteti	Orë Ditë/javë Gjithësej
Ligjërata	3 13 39
Ushtrime teorike/laboratorike	1 15 15
Punë praktike	
Kontaktet me mësuesin/konsultimet	1 2 2
Ushtrime në teren	8 2 16
Kollokfiime, seminare	3 2 6
Detyra të shtëpisë	1 2 2
Koha e studimit vetanëk të studentit (bibliotekë ose shtëpi)	2 15 30
Përgatitja përfundimtare për provim	1 15 15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2 5 10
Portfolio e studentit	1 15 15
Totali	150
Metodologjia e mësimit:	Ligjërata interaktive me pjesëmarrje aktive të studentëve; seminare, projekte individuale dhe grupore, konsultime, punë dhe detyra praktike në laborator dhe natyrë.
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësim formativ, projektet e studentëve, dy teste intermediere, portfolio e studentit, vlerësimi nga praktika dhe testi final. Vlerësim formativ ku përfshihen disa faza të vlerësimit:</p> <p>Vlerësimi i parë intermedier-----10%</p> <p>Vlerësimi i dytë intermedier-----10%</p> <p>Vlerësimi i punës praktike -----10%</p> <p>Portfolio e studentit-----5%</p> <p>Detyra seminarike individuale/grupore-----5%</p> <p>Angazhimi në klasë-----5%</p> <p>Vijueshmëria-----5%</p> <p>Testi final-----50%</p> <p>Total: -----100%</p> <p style="text-align: right;"><u>Pikët (%) Nota</u></p> <p style="text-align: right;">95 -100---- 10</p> <p style="text-align: right;">85 – 94---- 9</p> <p style="text-align: right;">75 – 84---- 8</p> <p style="text-align: right;">65 – 74---- 7</p> <p style="text-align: right;">55 – 64---- 6</p> <p style="text-align: right;">Deri 54-----5</p> <p>Sqarim: Vlerësimet intermediere- Vlerësimi i parë intermedier mbahet pas javës së 5</p>

	<p>të ligjëratave. Vlerësimi i dytë intermedier mbahet pas javës së 10 të ligjëratave. Nëse studenti humb dy (2) vlerësimet intermediere dhe pjesën praktike e humb të drejtën e hyrjes në provim për vitin akademik përkatës.</p> <p><i>Detyra seminarike</i> në formë detyre projektuese përgatitet dhe dorëzohet në fund të semestrit për vlerësim nga mësimdhënësit e lëndës.</p> <p><i>Pjesa praktike</i> e provimit është pjesë e vlerësimit final (me pikë).</p> <p><i>Portfolio e studentit</i>- përfshin materialet e kursit të studentit në një dosje: ligjëratat, prezantimet, fletoren e punës në ligjëratë, fletoren e punës së pjesës praktike, punët seminarike e individuale dhe çdo elemente tjetër të realizuar nga studenti në realizimin e kursit. Kjo vërteton angazhimin permanent të studentit gjatë kursit.</p> <p><i>Angazhimi në klasë</i>: secili student do të vlerësohet deri 5 pikë gjatë ligjëratave sipas presences, angazhimit dhe aktivitetit në klasë.</p> <p><i>Pikët nga pjesa formative e vlerësimit</i> (vlerësimet intermediere, projekti dhe praktika) vlejné brenda tri (3) afateve të rregullta të provimit.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Veselaj Z. 2018 “Mësimdhënia e biologjisë- strategjitë, metodat dhe teknikat”- leksione të përgatitura në Indiana University</p> <p>Paparisto A. 2016: Metodika e mësimdhënies në biologji, SHBLU, Tiranë</p>
Literatura shtesë:	<p>Garo S. (2013): Teoria dhe praktika e mësimdhënies, Albaian University Press, Tiranë.</p> <p>Musai B. 2008 “Mësimdhënia dhe të nxënimit ndërveprues” Biologji, CDE, Tiranë</p> <p>MASHT 2016: Kurrikula Bërthamë 2 për arsimin e mesëm të ultë</p> <p>MASHT 2016: Kurrikula Bërthamë 3 për arsimin e mesëm të lartë</p>

Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java 1:	Hyrje në kurs, prezantimi syllabusit dhe i qëllimeve të kursit dhe metodologjia e punës me grupin.
Java 2:	<i>Metodika e biologjisë si disiplinë shkencore dhe shkencë pedagogjike</i> Mësimdhënia dhe të nxënimit në biologji. Parimet e njohurive shkencore në biologji. Zhvillimi i aftësive në të nxënimit e biologjisë.
Java 3:	<i>Njohja dhe formimi i koncepteve bazë në të nxënimit e biologjisë</i> Shkathtësitë e të menduarit në lëndën e biologjisë. Të mësuarit dhe leximi në lëndën e biologjisë. Të nxënimit aktiv në biologji
Java 4:	Metodat e mësimdhënies së biologjisë. <i>Ciklet e të nxënimit në biologji. Modeli trehapësh dhe modeli 5E. Metodatat e zgjidhjes së problemeve në biologji. Të shkruarit si shkencëtar në biologji.</i>

Java 5:	Metodat e mësimdhënies në biologji. <i>Leksioni dhe shpjegimi në lëndën e biologjisë. Diskutimi, biseda dhe debati në të nxënit e biologjisë. Aftësitë e të pyeturit në lëndën e biologjisë.</i>
Java 6:	Testi i parë kontrollues
Java 7:	Metodat e mësimdhënies në biologji: <i>Formimi i koncepteve në të nxënit e biologjisë. Harta e koncepteve. Keqkonceptimet në shkencën e biologjisë.</i>
Java 8:	Metodat e mësimdhënies në biologji. <i>Modelimi në të nxënit e biologjisë. Të nxënit përmes lojës me role. Analogjitë në të nxënit e biologjisë. Të nxënit e biologjisë përmes situatave të mospajtitimit.</i>
Java 9:	Metodat e mësimdhënies në biologji: <i>Të nxënit e biologjisë përmes hulumtimit. Llojet e hulumtimeve në të nxënit e biologjisë. Vëzhgimi në të nxënit e biologjisë. Demonstrimi dhe eksperimenti në të nxënit e biologjisë.</i>
Java 10:	Metodat e mësimdhënies në biologji: Teknikat në të nxënit e biologjisë <i>Teknika e shenjave, VMLD., Di-Dua të Di-Mësova, Pesëvargëshi, Tabela e koncepteve, Rrethi, Teknika e kombinimit etj.</i>
Java 11:	Testi i dytë kontrollues
Java e 12:	Ora mësimore e biologjisë. <i>Tipet e orëve mësimore. Fazat e një ore varësisht sipas tipit të orës.</i>
Java 13:	Mësimdhënësi i biologjisë, detyrat dhe qëndrimi i tij në klasë. <i>Llojet e ekspertizës së mësimdhënësve. Mësimdhënësi hulumtues në biologji</i>
Java 14:	Mjetet mësimore dhe konkretizuese në të nxënit e biologjisë <i>Tekstet në të nxënit e biologjisë, Menaxhimi i klasës dhe motivimi i nxënësve për të nxënë</i>
Java 15:	<i>Biologjia dhe mësimdhënia e biologjisë në Kornizës Kurrikulare të Kosovës</i> Koncepti “Bota e gjallë”. Rezultatet e të nxënit të biologjisë në nivelin e shkollës së mesme.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime është i obliguar. Hyrja me kohë në ligjërata. Pas hyrjes së profesorit në klasë nuk lejohet hyrja dhe pengimi i mësimi. Mungesa në vijimin ligjëratave dhe sjellj et në kundërshtim me etikën akademike do të sanksionohen sipas dispozitave të Statutit të UP-s dhe Rregullores së Studimeve. Rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular etj.